

**Informacion i pergjithshem**

1. Kuadri ligjor : Ligji 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare”.
2. Kuadri kontabel i aplikuar: “Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi”
3. Baza e pergatitjes se Pasqyrave Financiare: Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.
4. Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e Pasqyrave Financiare.
  - Shoqeria “Albkontroll “ sha Durres, ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
  - Vijemesia e veprimtarise ekonomike e shoqerise sone nuk eshte e siguruar duke pasur ne plan vendimin e Asamblese per shpalljen e saj ne likudim..
  - Kompensim midis nje aktivi dhe nje pasivi ka vetem ne disa raste kur kemi te bejme me nje klient qe eshte edhe furnitor. Midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka kompensime vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
  - Kuptueshmeria e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjithshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
  - Materialiteti eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
  - Besueshmeria per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhtme:
    - Parimin e paraqitjes me besnikeri,
    - Parimin e perparetise se permbajtjes ekonomike mbi forme ligjore,
    - Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem,
    - Parimin e maturise pa optimizem te tepruar, pa nenvleresim dhe mbivleresim te qellimshem,
    - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te Pasqyrave Financiare,
    - Parimin e qendreshmerise per te mos ndryshuar politiket e metodat kontabel,
    - Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

**Politikat Kontabel**

Per percaktimin e kosos se inventareve eshte zgjedhur metoda “Kostos mesatare te ponderuar”. Theksojme se, qe ne krijimin e shoqerise sone eshte punuar me kosto mesatare te ponderuar dhe si pasoje nuk kemi ndryshim ne politiken kontabel ne lidhje me vleresimin e inventareve.

Vleresimi i Aktiveve afatgjata materiale eshte bere me koston historike (cmimin e blerjes se asetit plus te gjitha shpenzimet doganore, transport, montim etj).Ne pasqyrat Financiare zeri i aktiveve afatgjata materiale eshte paraqitur me vleren e mbetur (kosto minus anortizimin e akumuluar), ne perputhje me (SKK 5;21)

Per llogaritjen e amortizimit te Aktiveve afatgjata materiale ne perputhje me ( SKK5;38), shoqeria jone ka percaktuar si metode te amortizimit:

- Ndertesat me 5% te vlefes se mbetur,
- Pajisje zyre dhe informatike me 20 % te vlefes se mbetur,
- Impiante,makineri,pajisje dhe te gjitha aktivet e tjera afatgjata me 20 % te vlefes mbetur.

*EL*



Normat e amortizimit jane te perdorura brenda normave me ato te sistemit fiskal ne fuqi.

### SHENIMET SHPJEGUESE

Shenimet qe shpjegojne zerat e ndryshem te Pasqyrave Financiare.

#### AKTIVET AFATSHKURTERA

##### ➤ Mjete monetare

##### -Banka

Shoqeria jone kryen veprime bankare me disa banka te nivelit te dyte. Me poshte do te paraqesim gjendjen e llogarive ne leke dhe valute, sipas te gjitha bankave si dhe gjendjen e arkës me date 31/12/2020

KOD	PERSHKRIMI	MON	SASIA	KURSI	GJENDJE 30/12/2020
B01	Raiffeisen Bank Lek 000045665641	LEK			29.230
B08	BKT ne Lek 000404456	LEK			62.482
	SHUMA				<b>91.722</b>

##### -Arka

Nr	Emertimi i Arkes	Monedha	Vlera ne Valute	Kursi	Shuma ne leke
1	Arka ne Leke	Leke			0
			Shuma		<b>0</b>

##### ➤ Te drejta te arketueshme

- Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit ne shumen **6.103.781 leke**, perfaqeson kliente per sherbime si mostrim minerali,material ndertimi si dhe analiza kimike.Nga keto 35000 leke jane detyrim i vitit 2019 dhe 606 365 leke jane detyrim imuajve te fundit te vitit 2020 dhe 5462416 leke jane kerkesa ndaj shoqerise Albkrom sha Durres.

-Te drejta te tjera te arketueshme ,ne shumen **589,625 leke** perfaqeson tatimin mbi fitimin,detyrim i vitit 2012-2013.

##### ➤ Inventaret

-materiale te konsumueshme ne shumen **84 098 leke** perbehet nga materiale te ndryshme gjendje ne magazine ,te cilat perdoren per perdorim te brendshem.Lista e inventarit bashkelidhur.

#### II AKTIVET AFATGJATA

➤ Aktivet afatgjata materiale ne shumen **1.179.810 leke** jane si me poshte:

- Ndertesa provizore (Kioske metalike) **765.905 leke.**
- Impiante dhe makineri **349.960 leke.**
- Paisje informatike **63.945 leke.**



Ne pasqyrat financiare aktivet afatgjata materiale jane paraqitur me vleren e mbetur (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar).

Bashkelidhur jane pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit te aktiveve afatgjata materiale me vleren bruto, pasqyra e amortizimeve si dhe pasqyra e me vlere neto.

Theksojme se Zeri "Ndertesa Provozore"perbehet nga 1 kapanon metalik,me bazamentin prej betoni,ku eshte vendosur ne ambientet e marra me qira nga EMS Albanian Port Operator. Ne kete kapanon jane vendosur edhe makinerite dhe paisje qekane sherbyer per mostrime e perpunim mineralesh.Paisjet e zyrove dhe te laboratorit jane prane ambienteve te zyrove ne Durres,qe edhe keto jane me qira me subjekt privat.

## **I. DETYRIMET AFATSHKURTERA**

- Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit ,perfaqeson detyrimin ndaj furnitoreve ne shumen **2,529,694 leke**. Lista e furnitoreve bashkelidhur.
- Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore & shendetesore ne shumen **831,697 leke**,ku jane te perfshira :
  - Pagat e punonjesve ne shumen **668.203 leke** .(Lista emerore bashkelidhur)
  - Sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne shumen **163,494 leke** ,te cilat perfaqesojne sigurimet shoqerore & shendetesore te muajve te fundit te vitit 2020 .
- Te pagueshme per detyrime tatimore ne shumen **131 327 leke** ,te cilat perfaqesojne :
  - Detyrimet tatimore te Tap ne shumen **44,980 leke**
  - Detyrimin tatimore per tatimin ne burim ne shumen **43,440 leke** , eshte tatimi ne burim per muajin nendor-dhjetor 2020 .
  - Detyrime Tatimore te Tvsh-se **42,907 leke** ,eshte detyrimi i TVSH-se per muajin dhjetor 2020.
- Te tjera te pagueshme ne shumen **920,371 leke** ,shume e cila perbehet nga detyrimi qe ka shoqeria ndaj anetareve te keshillit mbikqyres te shoqerise ALBKONTROLL Sha.
- Provigjione afatshkurtra per klientin Albkrom sha durres ne shumen 5.462.416 leke
- Totali i detyrimeve afatshkurtra eshte **9,875,505 LEKE**

## **II.DETYRIME AFATGJATA**

- Detyrime Afatgjata ,shoqeria nuk ka.

## **III.KAPITALI**

• Kapitali i nenshkruar	37,039,972	leke
• Rezerva ligjore	221,884	leke
• Rezerva statutore	382,504	leke
• Fitimi i pashperndare	( 29,189,985)	leke
• Fitim/ humbja e periudhes	( 10,280,854)	leke

## **Shenimet e tjera shpjeguese**

Hartimi i pasqyres se te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin 2020.

- Te ardhurat gjithsej nga aktiviteti I shfrytezimit per vitin 2020 jane ne Shumen **3,840,321 leke**.



Te ndara si me poshte:

KOD	PERSHKRIM	SHUMA
704	Shitje sherbimesh mostrime dhe analiza mat.ndertimi	3,840,321
	<b>Shuma</b>	<b>3,840,321</b>

**Totali i te ardhurave 3,840,321**

Nga rakordimi i te ardhurave te paraqitura ne Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitin 2020 krahasuar me FDP kemi si me poshte:

- **Shpezimet spas zerave te pasqyres se performances jane :**
- Lende e pare dhe materiale te konsumushme ne shumen 210.478 leke.Keto shpenzime jane per blerje reagente kimike,nafte me tollona,kancelerti,bidona e gese plastike per mostrimin e materialeve ,pjese kembimi etj

**-Shpenzime te personelit 4.103.172 leke**

- Paga dhe shperblime ne shumen **3.516.000 leke**
- Shpenzime te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore **587.172 leke** perfaqeson shumen e kontributit te sigurimeve shoqerore qe perballohen nga shoqeria.

➤ Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale ne shumen **156.674 leke.**

Ne kete ze jane perfshire amortizimet e aktiveve afatgjata materiale, sipas normave te shpjeguara me lart. Bashkelidhur jane pasqyrat e amortizimit per vitin 2020.Theksojme ketu qe aktivet materiale jane shume te konsumuara ,shumica e tyre te blera e perdorura qe ne vitin 1962 e te tjera me pas.Kjo shifet edhe nga vlera e amortizimit te akumuluar qe eshte 6 848,076 leke ,me rreth 85 % te vleres fillestare te aktiveve.

> Zhvleresimi i kerkesave te arketushme ne shumen **5,462,416 leke.**Ne kete ze jane perfshire krijimi i provigjioneve per klientin "Albkrom"sha Durres.Jane detyrime te vitit 1999-2000,me vendim gjykate nr.1551 te vitit 2002.Ky detyrim parashikohet te mos arketohet,per pamundesite aftesise paguese te Klientit.

> Shpenzime te tjera shfrytezimi ne vleren 4.169.329 leke,ku perfshihen shpenzime nga te trete peranaliza kimike,peshe me zhytje anije,ekspertize pasqyrave financiare,per energji,uje ,telefon,mirembajtje etj.

> Shpenzime financiare ne vleren 19.106 leke

**Totali shpenzimeve eshte 14.121.75 leke**

**Rezultati humbje ne vleren 10.280.854 leke**



Gjithashtu te shuma e shpenzimeve jane perfshire edhe shpenzimet e panjohura per shumen **6.242.667 leke,nga te cilat 5.462.416 leke** jane shpenzimet per provigjione afatshkurtra,ndersa diferenca eshte taksa vendore te viteve te shkuara si dhe penalitete, gjoba, shpenzime , te cilat jane zbritur per efekt te llogaritjes se rezultatit fiskal

### REZULTATI TATIMOR

➤ Rezultati kontabel e vitit ushtrimor (humbje)	( 10.280.854) leke.
➤ Shpenzime te panjohura	6.242.667 leke.
➤ Humbje e mbartur	( 9.273.209) leke
➤ Humbja Tatimore	(13.311.396) leke

### Angazhime dhe detyrime te kushtezuara. (Çeshtje gjyqesore)

Deri me 31 dhjetor 2020,shoqeria nuk eshte e perfshire ne procedure ligjore,pretendime dhe ceshtje gjyqesore me palet e treta.

### Per Albkontroll sha Durre ne likujdim

**Hartoi**  
**EKONOMIST**

**Henrieta Xheneti**

**Miratoi**  
**ADMINISTRATORI**

**Eraldo MENE**

